



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 15 Mars 2022

Nr: 15

VENDIM

PËR

**MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 08, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 11.03.2022**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.03.2022, me pjesëmarrjen e:

Ilijan RUSMALI	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Krenar Hasanaj, anëtar i KZAZ nr.21, Qarku Durrës

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit nr. 11, datë 26.01.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Neni 124/1 i “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pika 8 e nenit 9 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të ndryshuar



Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka caktuar me vendimin nr. 11, datë 26.01.2022 masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 06.03.2022.
2. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim më datë 11.03.2022, anëtari i KZAZ-së nr.21, të Qarkut Durrës, z. Krenar Hasanaj me pretendimin se zbritja me 60% e masës së shpërblimit të komisionerëve nga zgjedhjet e përgjithshme në zgjedhjet e pjesshme vendore, formon një ndryshim “radikal”, i cili nuk justifikohet me ngarkesën më të vogël të punës në këto zgjedhje. Zbritja është “diskriminuese dhe mosvlerësuese e sakrificave të anëtarëve të KZAZ-së, pasi vëllimi i punës ka qenë i njejtë”. Për këtë arsye KQZ-ja duhet “të rishikojë masën e shpërblimit për anëtarët e KZAZ-së nr.21”.
3. Sipas ankuesit, ankimi “nuk u bë brenda afateve (24 orë), pasi vendimet e Rregullatorit dhe të Komisionerit mbi procesin nuk kishin dalë dhe KZAZ-ja nuk provonte dot ngarkesën e procesit dhe pretendimet e mësipërme”.
4. KAS-i caktoi me short relatorin z. Ilirjan Rusmali dhe zhvilloi seancën paraprake në datën 15.03.2022, me praninë e ankuesit dhe të administratës së KQZ-së, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj.

KAS-i konstatoi:

1. E drejta e shpërblimit për punën e kryer si anëtar i komisioneve zgjedhore është e drejtë që, për anëtarët e KZAZ-ve, buron nga pika 3, e nenit 29, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Vendimi nr. 11, datë 26.01.2022 “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie të disa njësive vendore të datës 6 mars 2022”, prek drejtpërdrejt këtë të drejtë të ligjshme të anëtarëve të KZAZ-ve, për pasojë ai vendim është i ankimueshëm nga këto subjekte.
2. Shqyrtimi administrativ i ankimit ndaj një akti të Komisionerit është kompetencë formale e KAS-it, e përcaktuar shprehimisht nga shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 21, të Kodit Zgjedhor.



3. Afati i ankimit ndaj akteve të komisionerit që kanë lidhje me zgjedhjet, për periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar bëhet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit (*pika 2, e nenit 124/1, të Kodit Zgjedhor*). Sipas pikës 8, të nenit 9, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve””, afati i ankimit 3 ditor bëhet 24 orë në rastin e zgjedhjeve të parakohshme dhe/ose të pjesshme. Ankuesi e ka paraqitur ankimin 44 ditë pas marrjes së tij.
4. Kërkesa ankimore nuk është shoqëruar me kërkesën për rivendosjen në afatin e ankimit dhe nga shqyrtimi paraprak rezultoi se ankuesi ishte i vetëdijshëm për karakterin prekluziv të afateve sipas Kodit Zgjedhor. Ankuesi e paraqiste ankesën për t’i dhënë mundësinë KQZ-së, me qëllim që të rishqyrtonte dhe të korrigjonte aktet dhe praktikën e shpërblimit të komisionerëve në këto zgjedhje.
5. Sipas nenit 54, të Kodit të Procedurave Administrative, “përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv”. Kodi Zgjedhor përcakton në pikën 5, të nenit 125, se “për afatet e ankimit, sipas kësaj pjese (*Pjesa X: ankimi në rrugë administrative i vendimeve të komisioneve zgjedhore*), nuk mund të ketë rivendosje në afat”. Kjo do të thotë se sipas Kodit Zgjedhor, mosrespektimi i afatit çon detyrimisht në humbjen e të drejtës për ankim.
6. Në këto rrethana KAS-i nuk mund të kalojë për shqyrtim dhe të investohet në trajtimin e vendimit objekt i kërkesës ankimore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenet 17, pika 3, shkronja “b” dhe neni 18, pika 1, shkronja “c” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,



V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 08, datë 11.03.2022, të paraqitur nga z. Krenar Hasanaj, anëtar i KZAZ-së nr.21, Qarku Durrës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar